



VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-qershor 2015 fq. 2
- » Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2015 fq. 3

ZHVILLIME TË TJERA

- » Seminar mbi aplikimin e teknikave të menaxhimit të riskut dhe të modeleve të brendshme fq. 5

LAJMET NGA RAJONI

- » Bjellorusi fq. 6
- » Letoni fq. 6
- » Mali i Zi fq. 7
- » Poloni fq. 7
- » Rumani fq. 8
- » Sllovaki fq. 8

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-qershor 2015

Tregu i sigurimeve u rrit me 20.91% gjatë periudhës janar-qershor 2015. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 6.4 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të policave të sigurimit me 9.15% duke arritur në 488,172 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 12.60% në krahasim me periudhën janar-qershor 2014. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.05 miliardë lekë, apo 71.79% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 25.08% gjatë periudhës janar-qershor 2015, krahasuar kjo me periudhën janar-qershor 2014.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën rreth 3.65 miliardë lekë gjatë periudhës janar-qershor 2015, duke shënuar një rritje prej 27.18% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 56.83% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 16.44% të tregut të Jo-Jetës;
- sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 14.66% të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 11.87% krahasuar me periudhën janar-qershor të vitit 2014. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori”, e cila përbën 63.45% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-qershor 2015

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.




Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2015

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-qershor 2015 u dominua në masën 65.14% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (*bono thesari*) dhe pjesa tjetër prej 34.86% ishin instrumente afatgjatë (*obligacione*). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 82.51% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-qershor 2015 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 70.03% dhe 13.65% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 97.75% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Letra me Vlerë të Qeverisë 2015



- A. Blerje në tregun primar
- B. Shitje nga portofoli i ndërmjetsit financiar
- C. Blerje para afatit të maturimit
- D. Vendosje e bonos si kolateral
- E. Shlyerje e vlerës nominale në maturim

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B **“Shitje nga portofoli i ndërmjetsit financiar”** gjatë periudhës janar-qershor 2015, ka pasur një ulje prej 214 milionë lekë ose 7.21% krahasuar me janar-qershor 2014. Gjithashtu është ulur edhe numri i transaksioneve në masën 6.39%.

Transaksioni i llojit C **“Blerje para afatit të maturimit”** gjatë periudhës janar-qershor 2015 ka pasur një rritje prej 1 milionë lekë ose 0.08% krahasuar me janar-qershor 2014, ndërsa numri i transaksioneve është ulur në masën 7.33%.

Krahasuar me janar-qershor 2014, vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 213 milionë lekë.

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale		Ndryshimi
	(në mln. lekë)		(në %)
Periudha janar-qershor	2014	2015	'15/'14-1
B Shitje nga portofoli i ndërmjetsit financiar	2,963.58	2,749.94	(7.21)
<i>Individë</i>	2,601.92	2,254.09	(13.37)
<i>Persona juridikë</i>	361.66	495.85	37.10
C Blerje para afatit të maturimit	1,346.51	1,347.55	0.08
<i>Individë</i>	1,126.45	1,274.15	13.11
<i>Persona juridikë</i>	220.06	73.40	(66.65)

ZHVILLIME TË TJERA

Seminar mbi aplikimin e teknikave të menaxhimit të riskut dhe të modeleve të brendshme

Instituti për Stabilitet Financiar (FSI), zhvilloi gjatë periudhës 5-10 korrik 2015, në Beatenberg, Zvicër, seminarin ndërkombëtar mbi aplikimin e teknikave të menaxhimit të riskut dhe të modeleve të brendshme. Në këtë takim të përvitshëm morën pjesë 22 përfaqësues nga shtete të ndryshme të botës si Belgjika, Hungaria, Gjermania, Malajzia, Polonia, Portugalia, Republika Çeke, Serbia, Singapori, Sllovakia, Turqia, Zvicra, etj. Seminari u zhvillua në formën e një tryeze diskutimi që synonte shkëmbimin e ideve e perspektivave të ndryshme lidhur me mbikëqyrjen dhe menaxhimin e riskut.

Temat kryesore që u trajtuan gjatë seminarit ishin:

- » *Standardet ndërkombëtare mbi menaxhimin e riskut dhe modeleve të brendshme.* Konkretisht u analizuan avantazhet dhe disavantazhet e qasjes së përgjithshme të mjaftueshmërisë së kapitalit, duke krahasuar metodën e standardizuar me atë të modeleve të brendshme;
- » *Modelimi i riskut financiar dhe i atij të tregut duke përdorur skenarë të ndryshme ekonomike, rasti i SCOR RE.* Në këtë prezantim u theksua rëndësia e zhvillimit (gjenerimit) të skenarëve të ndryshme në krijimin e modeleve të brendshme duke konsideruar korrelimin dhe varësinë ndërmjet të gjitha variablave të marrë në konsideratë;
- » *Modelimi i riskut të marrjes në sigurim duke përdorur instrumentin ReMetrica,* i prezantuar nga përfaqësues të shoqërisë AON Benfield (Broker), e cila me një rrjet që operon në 50 vende të botës, përfshirë dhe Shqipërinë, u ofron shoqërive të sigurimit një gamë të plotë shërbimesh në nënshkrimin e marrëveshjeve të risigurimit;
- » *Modelimi i riskut të siguruesit për shoqëritë e Jetës, rasti i Zurich Re.* Prezantimi u krye nga aktuarja e shoqërisë, e cila paraqiti një shembull konkret të modelimit të brendshëm të përdorur nga shoqëria për përllogaritjen e aftësisë paguese duke konsideruar risqet kryesore që karakterizojnë shoqëritë e Jetës, si mortaliteti, jetëgjatësia, etj;
- » *Modelet e brendshme të përdorura nga siguruesit, korniza e përgjithshme dhe praktikat më të mira, rasti i Swiss Re.* Gjatë prezantimit, u përshkrua qëllimi i modelit, që ka të bëjë me përcaktimin e probabilitetit të ndryshimeve në aftësinë paguese të shoqërisë duke konsideruar një afat kohor prej një viti, si dhe të gjitha fazat e ndërtimit të modelit të brendshëm të shoqërisë, nga mbledhja e të dhënave deri në miratimin e modelit, i cili në fazën pasardhëse do të përdoret për përllogaritjen e aftësisë paguese;
- » *Korrelacioni dhe varësia në menaxhimin e rrezikut.* Në prezantimin e kryer nga përfaqësuesi i FINMA, u vu në dukje rëndësia e modelimit të varësisë dhe korrelimit ndërmjet risqeve që karakterizojnë aktivitetet e ndryshme të industrisë së sigurimeve. Për matjen e varësisë u përdoren tregues të ndryshëm, si: koeficienti i korrelimit linear (Pearson), koeficienti i korrelimit të Spearman, koeficienti i korrelimit të Kendall, si dhe koeficienti i korrelimit të vlerave ekstreme.

Temat e mësipërme u prezantuan nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare të EIOPA-s; Swiss Re, Zvicrës, etj.

LAJMET NGA RAJONI

BJELLORUSI

www.xprimm.com

Sipas publikimeve për tremujorin e parë të vitit 2015 nga Shoqata Bjelloruse e Siguruesve (*Belarusian Association of Insurers*), totali i primeve në tregun e sigurimeve u rrit me 15% nga viti i kaluar duke arritur në 1,880 miliardë BYR (monedha lokale). E shprehur në monedhën evropiane, për shkak të zhvlerësimit të BYR në lidhje me Euron, tregu i sigurimeve nuk tregoi rritje të primeve të shkruara bruto dhe arriti 118 milionë euro, ose 2.2% më pak sesa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Dëmet e paguara nga kompanitë vendase arritën në 993.88 milionë BYR, gati 40% më shumë krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2014.

Duke analizuar shifrat financiare në monedhën vendase, volumi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ul me 23.84%, ndërsa sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 19.37% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2015, në tregun bjellorus të sigurimeve vepruan 24 shoqëri sigurimi, katër nga të cilët të specializuara në sigurimin e Jetës, 19 sigurues në tregun e Jo-Jetës dhe një kompani ekskluzive për risigurimin.

LETONI

www.xprimm.com

Sipas Komisionit të Tregut Financiar dhe Kapitalit të Letonisë (FKTK), tregu i sigurimeve në fund të tremujorit të parë të vitit 2015, arriti një total prej 151.21 milionë euro ose 5.98% më shumë sesa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, vlera e dëmeve të paguara u rrit me 11.69%, duke arritur në 75.64 milionë euro. Primet e shkruara bruto të degëve të shoqërive të sigurimit nga vendet e Bashkimit Evropian u ulën me 2.05%, duke arritur në 38.84 milionë euro, ndërkohë që shoqëritë siguruese vendase arritën në 112.38 milionë euro duke shënuar një rritje prej 9.06% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në total, sigurimi i Jetës arriti shifrën prej 25.95 milionë euro me rritje 6.33% më shumë sesa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Produktet e sigurimit të Jetës të lidhura me skema investimi u rritën me thujse 37% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në sigurimin e Jo-Jetës, përqindja më e madhe e totalit të primeve të shkruara bruto u raportua nga linja e sigurimit të pronës, e cila përfaqësoi afro 20.59% të tregut në total me afro 31.13 milionë euro, sigurimet për mjetet motorike (MTPL dhe sigurimi Kasko së bashku) me afro 35.53 milionë euro ose 23.50% e totalit, sigurime shëndetësore me afro 20.55 milionë euro, ose 13.59% e primeve të shkruara bruto në total.

MALI I ZI

www.ano.me/en/index.php?option=com_phocadownload&view=category&id=2:&Itemid=69

Sipas publikimeve në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrëse të Sigurimeve në Malin e Zi, (*Insurance Supervision Agency of Montenegro*) gjatë muajit qershor 2015 shifrat statistikore të sigurimeve paraqesin një volum të primeve të shkruar bruto në vlerën e rreth 6.56 milionë euro në segmentin e sigurimit të Jo-Jetës.

Disa nga grupet e sigurimeve që kishin pjesën më të madhe në raport me volumin total të primeve të shkruara bruto ishin sigurimi aksidenteve që zinte 10.54%, sigurimi nga zjarri dhe dëmet e tjera në pronë me 4.49%, dhe sigurimi MTPL me 43.52%.

Volumi i primeve të shkruar bruto në sigurimet e Jetës ishte rreth 1.19 milionë euro duke zënë rreth 15.38% të totalit të primeve të shkruar bruto të të gjithë tregut.

POLONI

piu.org.pl/analysis-and-publications/project/1897/pagination/1

Sipas një publikimi nga Dhoma Polake e Sigurimit (*Polish Chamber of Insurance*) në faqen zyrtare, gjatë tremujorit të parë 2015, tregu i sigurimeve kishte këta tregues:

Tregu i sigurimit të mjeteve motorike:

- » Primet e shkruara bruto mbi sigurimin e përgjegjësisë civile (OC) arritën në 1.9 miliardë PLN (Zlota polake) ose afërsisht 450 milionë euro, me një rënie prej 2.3%.
- » Primet e shkruara bruto për sigurimet e plota CASCO (AC) të automjeteve arritën në 1.4 miliardë PLN, ose rreth 330 milionë euro.
- » Kompensimet sipas sigurimit të përgjegjësisë civile (OC) të automjeteve tokësore (duke përfshirë sigurimin e përgjegjësisë civile të pronarëve të tyre) arritën në 1.6 miliardë PLN, ose rreth 380 milionë euro, me një rritje prej 9.7%.

Tregu i sigurimit të Jo-Jetës (pa përfshirë sigurimin motorik)

- » Primi total i sigurimit Jo-Jetë (pa përfshirë sigurimin motorik) arriti vlerën 3.8 miliardë PLN (rreth 910 milionë euro) dhe ishte 4.6% më i lartë sesa një vit më parë.
- » Sigurimi ndaj zjarrit dhe fatkeqësive të tjera natyrore vazhdoi të mbulojë pjesën më të madhe të primeve në tregun e sigurimit të Jo-Jetës, mbi 1 miliardë PLN.

Tregu i sigurimit të Jetës

- » Kompensimet dhe përfitimet totale të paguara në sigurimin e Jetës arritën vlerën prej 5.2 miliardë PLN (rreth 1.24 miliardë euro) me një ulje prej 10.8%.
- » Vlera e primeve në sigurimin e Jetës u rrit me 3.7%, në vlerën 7.2 miliardë PLN.
- » Vlera e primeve në sigurimin e aksidenteve po rritet në mënyrë të vazhdueshme. Ajo arriti në 1.3 miliardë PLN për tremujorin e parë të vitit 2015.

Sipas faqes në internet www.xprimm.com e cila i referohet treguesve financiarë të publikuar nga Autoriteti Polak i Mbikëqyrjes Financiare, në total primet e shkruara bruto të siguruesve polakë u rritën me 2.95% në krahasimin me vitin e kaluar duke kapur shifrën 14.37 miliardë PLN në tremujorin e parë të vitit 2015.

RUMANI

www.asfromania.ro/en/press-releases/media-releases/4331-decisions-adopted-by-the-fsa-board-30-july

Sipas njoftimit në faqen zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Rumanisë, (*Consiliul Autorității de Supraveghere Financiară*) Bordi i tij miratoi në sesionin e 29 korrik 2015 disa rregullore të lidhura me menaxhimin e sistemit të pensioneve private, të tilla si draft rregullorja mbi raportimin dhe detyrimet e transparencës në sistemin e pensioneve që menaxhohet privatisht dhe draft rregullorja mbi raportimin dhe detyrimet e transparencës në sistemin e pensioneve vullnetare, i cili do të aplikohet si një proces pilot për tre muaj. Këto rregulla, të cilat janë përditësim i rregullave të mëparshme optimizojnë sistemin e raportimit për fondet e pensioneve vullnetare dhe fondet që menaxhohen privatisht dhe rrisin shkallën e transparencës së menaxherëve.

Gjithashtu, Bordi i Autoritetit Rumun miratoi ndryshime dhe plotësime në rregulloren mbi investimin dhe vlerësimin e asetëve të fondeve private të pensioneve. Qëllimi i këtij drafti është përmirësimi i shkallës së klasifikimit të rrezikut të një fondi pensioni, mundësinë e tregtimit të obligacioneve të korporatave dhe ato bashkiake në OTC (*Over-The-Counter*) dhe mbrojtjen e portofolit të fondeve të pensionit vullnetar ndaj risqeve të interesit nëpërmjet derivateve specifike.

SLLOVAKI

www.xprimm.com

Siç treguan statistikat paraprake në tre muajt e parë të vitit 2015, vlera totale e primeve të shkruara bruto të shoqërive të sigurimit anëtarëve të Shoqatës Sllovaqe të Sigurimeve, SLASPO, është rritur me rritje vjetore prej 3.62% duke arritur në 632.29 milionë euro.

Në tremujorin e parë, tregu vazhdoi të dominohet nga sigurimi i Jetës, i cili përfaqësoi 51.55% të volumit total të primeve (me një rritje prej 4.8% të primeve të shkruara bruto, duke arritur në 325.94 milionë euro). Sigurimi i Jo-Jetës mbuloi 48.45% të tregut, nga të cilat 24.23% u gjeneruan nga policat e sigurimit të mjeteve motorike: sigurimi Kasko dhe MTPL.